



BULETIN JAVOR

8-12 PRILL 2024

Shprehja

"Ransomware është unik në mesin e krimit kibernetik, sepse, në mënyrë që sulmi të jetë i suksesshëm, ai kërkon që viktima të bëhet një bashkëpunëtor i gatshëm pas faktit."

James Scott

e javës

Përmbajtja:

- Mbrojtja Online e Fëmijëve dhe të Rinjve
- AT&T - Data Breach
- Zero Day Alert




Mbrojtja Online e Fëmijëve dhe të Rinjve

Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese për Mbrojtjen Online të Fëmijëve dhe të Rinjve, në datën 9 Prill AKCESK në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) zhvilloi në qytetin e Lezhës një orë leksioni të hapur në gjimnazin "Hydajet Lezha", për përdorimin në mënyrë të sigurt të internetit.

Në këtë takim u përfshinë nxënësit, mësuesit, psikologja e shkollës, oficeri i sigurisë, drejtoresha dhe nëndrejtoresha e shkollës.

Leksione të tilla kanë për qëllim udhëzimin e nxënësve mbi mënyrat e përdorimit të sigurt të teknologjisë dhe internetit. Kjo përfshin këshillimin për të vepruar me kujdes në hapësirën digjitale në mënyrë që të rrisim përfitimet nga teknologjia dhe shmangien e rreziqeve të mundshme.




AT&T - Data Breach

AT&T, kompania amerikane e telekomunikacionit ka informuar 51 milionë klientë për një shkelje të të dhënave që ekspozoi informacionin e tyre personal në një forum hackerimi. Të dhënat prekën gjithsej 51,226,382 klientë, me informacion që ndryshonte sipas individit dhe llogarisë.

Kompania nuk ka bërë të ditur se si u vodhën të dhënat dhe pse iu deshën pothuajse pesë vjet për të konfirmuar se i përkisnin atyre.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Zero Day Alert

Palo Alto Networks ka identifikuar një defekt kritik në softuerin e tij PAN-OS, i cili mund të lejojë një sulmues të paaumentuar të ekzekutojë kodin arbitrar me *root privileges* në portat e tij GlobalProtect.

Ky vulnerabilitet prek versionet e PAN-OS dhe është i zbatueshëm vetëm për *firewall*-et me portën GlobalProtect dhe telemetrinë e pajisjes të aktivizuar. Çështja është zbuluar nga kompania e inteligjencës së kërcënimeve Volexity. Palo Alto Networks këshillon klientët me një abonim për Parandalimin e Kërcënimeve për të aktivizuar ID-në e Kërcënimit 95187 për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

[Link: Lexo më shumë](#)